

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 11 milionë USD.

Projekti ka për qëllim të mbështesë zbatimin e reformave të ndërmarra për përmirësimin e vendosjes së drejtësisë dhe rritjen e efikasitetit të programeve të ndihmës sociale në Shqipëri.

Objektivat që synohen të arrihen janë:

- i. mbështetja e zbatimit të përmirësuar të programit të ndihmës ekonomike (në vijim, NE) dhe programit të aftësisë së kufizuar (në vijim, PAK);
- ii. mbështetja e kapaciteteve për zbatimin e përmirësimeve të programeve të mbrojtjes sociale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, kapitulli 3, “Shërbimet publike”, seksioni 3.3, “Shëndetësia dhe kujdesi social”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ratifikimi i marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, do të mundësojë:

- i. rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale;
- ii. një strategji novatore dhe të mbështetur në përvojën ndërkombëtare për daljen e përfituesve të NE-së dhe integrimin e tyre drejt skemave aktive;
- iii. përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve e të gabimeve dhe mekanizmave të tjerë të inspektimit social;
- iv. nxitjen e transparencës në komunikim e monitorim-vlerësim, si edhe në angazhimin e qytetarëve në këto procese.

Financimi i këtij projekti mundëson zbatimin e programeve të përmirësuara të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Kjo do të arrihet nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që huamarrësi ka bërë nga fondet e tij buxhetore për programin e ndihmës sociale (programin e shpenzimeve të lejuara). Do të mundësohet gjithashtu asistenca teknike për forcimin e kapaciteteve zbatuese të programeve të mbrojtjes sociale.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje është data 30 qershor 2021.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i projektligjit bazohet në nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.206, datë 11.4.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *aquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për

shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, me një hua në shumën 11 milionë USD.

Marrëveshja e huas i bashkëlidhet projektligjit dhe përmban 6 nene, 4 skedule dhe 1 shtojcë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja e akorduar nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka termat financiarë të mëposhtëm:

Shuma:	11 000 000 USD;
Interesi:	bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm;
Tarifa <i>Front-end</i> :	0.25% e shumës së huas;
Komision angazhimi:	0.25%, që përlogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas;
Maturimi:	27 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali.

Projekti do të jetë pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

KËSHILLI I MINISTRAVE